

VENDIM
Nr.308, datë 16.4.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.140, DATË 20.3.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PARAQITJES, FORMËS DHE SHENJAVE DALLUESE TË UNIFORMËS, NË NJËSI TË VEÇANTA TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33, të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005, “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.140, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“4. Paraqitja dhe forma e uniformës së shërbimit janë të përcaktuara në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit miraton normën e furnizimit me shenja dalluese dhe mënyrën e përdorimit të tyre, për të vijuar me procedurën e blerjes.”.

b) Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Punonjësit e strukturës përgjegjëse për sigurinë fizike të objekteve dhe informacionit të klasifikuar të trajtohen sipas statusit të punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2020, miratuar për programin buxhetor të Shërbimit Informativ të Shtetit.

3. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama